

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE-Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren Franciska Zhitia-Ymeri, në çështjen juridike të paditësit Auto Shkolla “A.” me seli në P., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit S.A. avokat nga P., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.” (ish G. E.), me seli në P., të cilën e përfaqësoj sipas autorizimit E.N.-B. juriste nga P., me objekt kontesti fitim të humbur, pas përfundimit të seancës kryesore publike të datës 18.10.2017, pas marrjes së fjalëve përfundimtare nga palët në procedurë, ndërsa me datë 07.11.2017, merr këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Auto Shkolla “A.” me seli në P..

I. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “E.” (ish G. E.), me seli në P., që paditësit t’ia paguaj në emër të fitimit të humbur shumë prej 172.00 euro (njëqind e shtatë dhjetë e dy euro), me kamatë të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e deponuara në kursim me afat mbi 1 vit e pa destinim të caktuar duke filluar nga data 31.05.2012, e deri në pagesën definitive të gjitha këto në afatin parativ prej 7 (shtatë) ditëve, duke llogaritur nga data e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

II. REFUZOHET si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë në vlerë prej 15,410.21 euro.

III. Shpenzimet e procedurës kontestimore i bartin secila palë veç e veç.

A r s y e t i m

Paditësi Autoshkolla “A.” me seli në P., ka paraqitur padi pranë kësaj Gjykate për fitimin e humbur për shkak të pamundësisë për të punuar me automjetin e aksidentuar me datë 31.05.2012, duke kërkuar aprovimin e shumë prej 15,582.51 euro, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.” (ish G. E.) me seli në P..

Gjykata Themelore në Prishtine-Departamenti për Çështje Ekonomike me Aktgjykimin III.C.nr.322/2014 të datës 05.05.2015 kishte aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe e kishte detyruar të paditurën që në emër të fitimit të humbur t’ia paguaj shumë prej 187.65 euro, me kamatë ligjore prej 3.5% duke filluar nga data 31.05.2012, e deri në pagesën definitive si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore që secila palë ti bartë veç e veç, ndërsa pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit shumë prej 15,394.96 euro, në emër të fitimit të humbur e kishte refuzuar si të pabazuar.

Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtine-Departamenti për Çështje Ekonomike paditësi kishte ushtruar ankesë në bazë të cilës Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktvendimin Ae.nr.108/2015 të datës 15.04.2016, ankesën e paditësit e ka aprovuar dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim.

I autorizuari i paditësit ka mbetur pranë parashtresës së datës 17.06.2017, me të cilën ka bërë precizimin e kërkesëpadisë së tij dhe atë në emër të fitimit të humbur në shumë prej 15,582.21 euro, duke e llogaritur çdo ditë të humbur në emër të mungesës së automjetit të dëmtuar për shkak të aksidentit të pësuar dhe mos-rregullimin e tij nga data 31.03.2012 e deri me datë 03.01.2015, andaj edhe i ka propozuar gjykatës që të aprovoi padinë dhe kërkesëpadinë e tij si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

E autorizuar e të paditurës e ka kontestuar në tërësi padinë dhe pretendimet e palës paditëse për faktin se sqarimet e bëra nga eksperti N.Sh.ekspert i makinerisë dhe eksperti A.B.ekspert i Aktuaristikës ka argumentuar në mënyrë profesionale faktet lidhur me fitimin e munguar lidhur me rregullimin e automjetit të dëmtuar të palës paditëse dhe sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit se sa është koha e arsyeshme për riparimin e automejtit, duke shtuar se e paditura me kohë i ka ofruar ofertën paditësit për mundësinë e riparimit të automjetit në autoserviset e autorizuar, andaj edhe i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Për zgjidhjen e kësaj çështje juridike Gjykata i administroi provat e propozuara nga palët në procedurë dhe atë duke filluar nga: raporti policor i datës 31.03.2012, procesverbali mbi dëmtimin e automjetit i datës 02.04.2012, foto dokumentacioni, njoftimi i paditurës i datës 3005.2012, ekspertiza e aktuaristikës e punuar nga z.A.B., e datës 03.08.2012, ekspertiza teknike nga z.N.Sh., e datës 25 korrik 2012, njoftim i datës 05.04.2012, akt vlerësim i dëmit datë 05.04.2012, vlerësim-porshe e datës 14.09.2012, faturë e datës 31.01.2015, certifikata e regjistrimit me nr. të biznesit ..., plotësimi i ekspertizës teknike e datës 27.02.2017, urdhër pagesë e datës 13.03.2015, përgjigje në ankesë nga BQK-ja, me nr. 212/449 e datës 25.06.2012, plotësimi i ekspertizës nga eksperti i aktuaristikës A.B., e datës 13.04.2017, plotësimi i ekspertizës nga N.Sh.e datës 08.08.2017, dhe plotësimi i ekspertizës së ekspertit të aktuaristikës të datë 16.10.2017.

Gjykata ka vlerësuar vëretjet dhe sugjerimet e Gjykatës së Apelit, ka dëgjuar palët në kontest dhe përfaqësuesin ligjor të paditësit si dhe ka kërkuar plotësimin e ekspertizës së makinerisë nga eksperti N.Sh.dhe të ekspertizës së aktuaristikës nga eksperti A.B.për të vërtetuar kohën e arsyeshme për riparimin e automjetit dhe gjeti se padia dhe kërkesëpadia e paditësi është pjesërisht e bazuar, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në mes palëve në procedurë nuk ishte kontestuese se automejti i paditësit i dëmtuar në aksidentin e datës 31.03.2012, kishte të kontraktuar policën e sigurimit me të paditurën këtu Kompaninë e Sigurimeve "E." me seli në P..

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate kontestues në mes palëve në kontest është fakti se a ka pasur vërtetë paditësi fitim të humbur si pasojë e pamundësisë së shfrytëzimit të automjetit të aksidentuar, siç ka pretenduar paditësi dhe të vërtetohet koha e arsyeshme për riparimin e automjetit të aksidentuar.

Gjykata nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit për vlerësimin e dëmit eksperti N.Sh.dhe plotësimit të ekspertizës së datës 08.08.2017, ka konstatuar se koha e arsyeshme për rregullimin e automjetit është 3 deri në 4 ditë, ndërsa lifterimi i pjesëve kur nuk janë në stok 1 javë apo 7 ditë, që sipas ekspertit dhe përgjigjes së marrë nga autoservisi i autorizuar "B. A." me seli në P., është vlerësuar koha e arsyeshme për riparimin e automejtit është gjithsej

11 ditë, duke llogaritur edhe lifetrimin e tyre në stok, për riparimin e një automjetit të aksidentuar siç është automjeti i paditësit.

Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit të aktuaristikës A.B.dhe plotësimit të ekspertizës së datës 16.10.2017, për vlerësimin e fitimit të humbur për 11 ditë, u konstatua se paditësi për shkak të pamundësisë së zhvillimit të veprimtarisë me automjetin e aksidentuar prej 11 ditësh ka pësuar fitim të humbur në shumë prej 172.00 euro dhe atë duke e llogaritur për një ditë pune nga 15.64 euro.

Për të përcaktuar kompenzimin e fitimit të humbur Gjykata është bazuar në nenin 189 paragrafi 3 të LMD-së, në të cilin ceket se *“Gjatë vlerësimit të shumës së përfitimit të munguar merret në konsiderim fitimi ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas procesit të rregullt të sendeve ose sipas rrethanave të veçanta ndërsa realizimi i të cilave është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga ometimi”* dhe nenit 190 të njëjtit ligj, thuhet se *“Gjykata duke marrë parasysh edhe rrethanat që kanë lindur pas shkaktimit të dëmit do të gjykojë kompensimin në një shumë që nevojitet që gjendja materiale e dëmtuesit të sjellet atje ku do të ishte po të mos kishte veprim dëmtues ose ometim”*, andaj edhe duke u bazuar në dispozitat e lartë cekura lartësinë e shumës së gjykuar për kompenzimin e fitimit të humbur në shumë prej 172.00 euro, gjykata e përcaktoj në bazë të mendimit dhe konstatimit të ekspertit nga lëmia e aktuaristikës dhe financave A.B.dhe plotësimit të ekspertizës së datës 16.10.2017, i cili lartësinë e fitimit të humbur e ka përcaktuar në bazë të plotësimit të ekspertizës së ekspertit N.Sh.të datës 08.08.2017, i cili ka konstatuar se automjeti i dëmtuar i paditësit për tu riparuar pranë një serivisi të autorizuar siç është “B.A.” duhet 3 deri në 4 ditë, ndërsa kur në stok nuk ka pjesë nevojitet 7 ditë për liferimin e tyre në stok, gjithsej 11 ditë për riparimin e automjetit të paditësit.

Gjykata pjesën tjetër të kërkespads së paditësit në shumë prej 15,410.21 euro e ka refuzuar si të pabazuar sepse e paditësi nuk ka ofruar asnjë provë lidhur me arsyet e vonesës e riparimit të automjetit, ndërsa sipas nenit 319.1 dhe 322.2 të LPK-së, palët ndërgjyqëse kanë për detyrë që t'i provojë faktet dhe kërkesat mbi të cilat e bazojnë pretendimet e tyre.

Gjykata po ashtu ka vlerësuar edhe rekomandimet e Gjykatës së Apelit me aktvendimin Ae.nr.108/15, të dates 15.04.2017, lidhur me atë se e paditura me veprimet e saja a ka ndikuar në zvarritjen e procedurës së riparimit të automjetit, gjykata ka gjetur se e paditura me sjelljet e veta nuk e ka zvarritur procedurën për riparimit të automjetit të paditësit për arsye se ka vepruar brenda të gjitha afateve ligjore dhe sipas rregullorës mbi procedurat e trajtimit të dëmeve të BQK-së, përkatësisht duke u bazuar në *“Rregulloren mbi procedurat e trajtimit të kërkesave për kompensimin e dëmeve që rrjedh nga sigurimi i detyrueshëm nga autopërgjegjësia”* (e datës 27.10.2012), në nenin 7 pika a), se i ka dhënë oferta paditësit për riparimin e automjetit brenda afateve ligjore kjo vërtetohet nga njoftimi i dates 05.04.2012 dhe aksidenti ka ndodhur me date 31.03.2012, kjo do të thotë se e paditura brenda 4 ditëve ju ka përgjigjur paditësit, mirëpo i njëjti nuk është pajtuar me ofertën e pare të paditurës dhe ka kërkuar rishqyrtim. E paditura e ka bërë rishqyrtimin e rastit dhe brenda afatit ligjor përkatësisht me datë 30.05.2012, i ka paqaritur ofertën e dytë paditësit, gjegjësisht e paditura me veprimet e veta nuk e ka zvarritur procedurën e riparimit të automjetit, andaj edhe gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me vendosjen për pagesën e kamatës vjetore gjykata e ka bazuar në nenin 277 të LMD-së, dhe atë kamatën të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e deponuara në kursim me afat mbi 1 vit e pa destinim të caktuar duke filluar nga data 31.05.2012, e deri në pagesën definitive.

Lidhur me vendimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore të cekur si në dispozitivit të këtij aktgjykimi gjykata u bazuar në nenin 452.2 lidhur me nenin 450 të LPK-së.

Pas shqyrtimit të të gjitha provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës gjykata ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi duke u bazuar në nenin 189 paragrafi 3 dhe 190 të LMD-së si dhe në bazë të nënit 143 paragrafi 1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE.

**Departamenti për çështje ekonomike
III.EK.nr.223/16 me datë 07.11.2017**

Gjyqtarja
Franciska Zhitia-Ymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të të njëjtit, duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.